



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT
MUNICIPALITY OF DEÇAN
OPSTINA DEÇAN



Drejtoria për Zhvillim Ekonomik

NJOFTIM ZYRTAR

Iniciativë e re për promovimin e aktiviteteve turistike në Komunën e Deçanit

Të nderuar qytetarë, vizitorë dhe partnerë të turizmit,

Në kuadër të përkushtimit për zhvillimin dhe promovimin e turizmit lokal, Drejtoria për Zhvillim Ekonomik në Komunën e Deçanit ka ndërmarrë një iniciativë të re për promovimin e aktiviteteve turistike, kulturore dhe natyrore që zhvillohen në komunën tonë.

Duke filluar nga kjo javë, faqja zyrtare e turizmit “Visit Deçani” do të publikojë çdo javë një postim promovues, i cili do të përfshijë aktivitete të organizuara nga OJQ-të, grupet lokale dhe iniciativat qytetare – pavarësisht nëse janë nga Deçani apo nga jashtë tij – për aq kohë sa ato ndërlidhen me bukuritë dhe potencialet turistike të Komunës së Deçanit.

Qëllimi ynë është të rrisim dukshmërinë e aktiviteteve që zhvillohen në komunë dhe të krijojmë një platformë të qëndrueshme për promovim dhe informim të publikut vendor dhe ndërkombëtar.

Ftojme të gjithë qytetarët, organizatat dhe dashamirësit e turizmit që të bashkëpunojnë me ne, të ndajnë informatat dhe materialet për aktivitetet që organizojnë, dhe të na ndihmojnë në shpërndarjen e këtyre përmbajtjeve.

Le të vazhdojmë së bashku ta promovojmë Deçanin – një vend me natyrë të mrekullueshme, trashëgimi të pasur dhe mikpritje të rrallë.

Për informata shtesë dhe për të dërguar materiale për publikim, ju lutemi kontaktoni:

Email: qit.decan@gmail.com

Facebook: Visit Deçani

Tel: +383 46 111 334

Me respekt,

Drejtoria për Zhvillim Ekonomik

Komuna e Deçanit

